

U D H Ë Z I M
Nr. 52, datë 18.6.2001

PËR NGRITJEN E QENDRAVE TË VOTIMIT NË INSTITUCIONE TË POSAÇME

Në mbështetje të neneve 18, 47, 59 dhe 93 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

U D H Ë Z O N :

1. KZZ-ja që ka brenda territorit të zonës së saj institucione të posaçme (spitale, burgje, vende paraburgimi) krijon në këto institucione qendër votimi të veçantë, kur në to ditën e votimit janë të paktën 15 zgjedhës.

2. Drejtuesi i institucionit, kur konstaton se në institucionin që drejton ka mbi 15 votues, tre ditë përpara datës së zgjedhjeve, brenda orës 18.00, dorëzon në KZZ-në përkatëse listën e votuesve (sipas modelit bashkëlidhur), të nënshkruar dhe vulosur në çdo faqe.

3. Me sigurimin e këtyre listave, KZZ-ja merr vendim për ngritjen:

a) qendrës së votimit,

b) komisionit të qendrës së votimit, me të njëjtën formulë dhe në të njëjtën mënyrë, si dhe për qendrat e tjera të votimit.

4. Drejtuesi i institucionit i siguron komisionit të qendrës së votimit, mjediset e përshtatshme dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin normal të qendrës së votimit, të paktën 24 orë përpara datës së zgjedhjeve, ora 18.00.

5. KZZ-ja dhe komisioni i qendrës së votimit, kryejnë të gjitha procedurat për përgatitjen e qendrës së votimit dhe realizimin e procesit të votimit, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e KQZ-së dhe manualit të qendrës së votimit, njëjloj si gjithë qendrat e tjera të votimit të KZZ-së.

6. Nëse në një institucion ka më pak se 15 zgjedhës, nuk krijohet qendër votimi dhe drejtuesi i institucionit duhet të marrë gjithë masat e mundshme për t'u krijuar kushte votuesve për të ushtruar të drejtën e votës në vendbanimin (ose vendqëndrimin) e votuesit për rastin e spitaleve ose përfshirjen e tyre në listën e votuesve të një institucioni të ngjajshëm për rastin e të burgosurve ose të paraburgosurve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari

Gaspër Kokaj

Ministria e _____

Drejtoria e _____

Lista e votuesve të institucionit të posacëm _____

Nr.	Emri atësia mbiemri	Datëlindja	Firma
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			
10.			
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			

Vula

D R E J T O R I
(_____)

_____ më, 21.6.2001